

# *Bashkëpunimi i institucioneve parashkollore me prindërit drejt edukimit në fëmijërinë e hershme*

*Arbërore Bicaaj, Prof. Asst. Dr.*

*arberore.bicaaj@aab-edu.net*

*Alberita Bytyqi, MA*

*Tringa Azizi, Prof. Asst. Dr.*

*Arbona Xhemajli, Prof. Asst. Dr.*

## **Abstrakt**

Edukimi parashkollor dhe, në veçanti, edukimi parashkollor i institucionalizuar është shumë i rëndësishëm për fëmijërinë e hershme. Në këtë kontekst, bashkëpunimi me prindërit paraqitet si çështje me rëndësi për cilësinë dhe për ndikimin e edukimit në fëmijërinë e hershme. Shpeshherë, prindërit nuk janë të vetëdijshëm se ata e luajnë rolin themelor në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre nëpërmjet pjesëmarrjes aktive dhe bashkëpunimit me personelin dhe institucionet e edukimit parashkollor.

Hulumtimi trajton bashkëpunimin e prindërve me institucionet parashkollore (IP) dhe ndërlihdjen e këtij bashkëpunimi me faktorë si: komunikimi, mjedisi shkollor, përdorimi i transferit të përvojave profesionale të prindërve dhe njohja e prindërve me politikën e edukimit parashkollor (edukimit në fëmijërinë e hershme)<sup>1</sup> në funksion të edukimit të fëmijëve. Hulumtimi është realizuar nëpërmjet qasjes sasiore me prindër (N = 60) dhe nëpërmjet qasjes cilësore me edukatorët, duke shqyrtuar sfidat dhe nevojat për përmirësimin e një bashkëpunimi të tillë,

---

<sup>1</sup> Dokumentet si: Standardet e përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor në Kosovë (0-6 vjeç); Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0 - 6; si dhe Kurrikula e edukimit parashkollor në Kosovë.

si dhe rolin dhe mundësitë e të dyja palëve drejt realizimit të një bashkëpunimi sa më efektiv.

Gjetjet e dala nga hulumtimi dëshmojnë se identifikimi i formave dhe i faktorëve të bashkëpunimit me prindër ndikon në forcimin e rolit të trekëndëshit institucion parashkollor/familje/komunitet, si dhe në rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve, nëpërmjet institucioneve parashkollore, për rëndësinë e një bashkëpunimi të tillë.

**Fjalë kyç:** *fëmijëri e hershme, bashkëpunim, komunikim, prindër, institucione parashkollore.*

Edukimi parashkollor si term, u referohet të gjitha shërbimeve që ofrohen për fëmijët deri në moshën gjashtëvjeçare (Taguchi & Munkammar, 2003). Përfshirja e prindërve<sup>2</sup> në punën edukative të institucioneve parashkollore (IP) në periudha të ndryshme është parë si e panevojshme, por në fakt ka një rëndësi thelbësore për edukimin e fëmijës (Miller, 2003).

Në fokus të bashkëpunimit ndërmjet prindërve dhe institucionit parashkollor është fëmija. Mjaft autorë kanë pasqyruar rëndësinë e bashkëpunimit me prindër të shumtë, nëpërmjet rrugëve të ndryshme. Kjo paraqet një mundësi për përfshirjen e prindërve pasi që ndikon në përmirësimin e punës së edukatoreve (Sandberg & Vuorinen, 2008).

Në një studim të kryer në Pitsburg, thuhet se përfshirja e prindërve në shkollë<sup>3</sup> është një komponent i rëndësishëm i

---

<sup>2</sup> Me përfshirje të prindërve në IP mendohet në aspektin e bashkëpunimit, nëpërmjet formave të ndryshme, duke kontribuar në edukimin e fëmijëve në fëmijërinë e hershme.

<sup>3</sup> Pavarësisht që shpjegimi që jepet ndërlidhet me shkollën/nxënësit, nuk ka ndonjë arsye të mos besohet se logjika e tillë, sa i përket bashkëpunimit me

edukimit në fëmijërinë e hershme për të ndihmuar promovimin e të ashtuquajturit "efekt afatgjatë" (Barnard, 2004). Kur kemi të bëjmë me fëmijërinë e hershme, ekspertët theksojnë se veçoria kryesore e këtij niveli të edukimit është karakteri i tij inkluziv. Në mesin e shtatë fushave që ata kanë specifikuar në librin e tyre "Fëmijëria e hershme, edukimi sot" përfshihet edhe praktika e përqendruar në familje. Këtu bëhet e qartë se, për plotësimin e nevojave të fëmijëve, edukatorët e fëmijëve në fëmijërinë e hershme duhet të bashkëpunojnë me familjet dhe me komunitetin (Morrison, 2007, p. VI). Njëherazi, Coleman në vitin 1988, përfshin termin 'kapital social' për ekzaminimin e marrëdhënies midis familjes dhe shkollës, për arritjet e nxënësve (Coleman, 1988). Nëse i referohemi kapitalit social, si arsye kryesore e rënies së performancës shkollore dhe, po ashtu, e rënies së nivelit në kryerjen e detyrave të fëmijëve nëpër institucione parashkollore është konsideruar humbja e cilësisë së kohës interaktive fëmijë - i rritur. Pastaj, këtu është vërejtur edhe që koha në dispozicion e prindërve për të qëndruar afër institucioneve parashkollore është në rënie, dhe kjo për shkak të rritjes së numrit të familjeve me një prind dhe të familjeve me të ardhura të dyfishta (Office of Student services, 2002).

Në këtë kontekst, hulumtimi analizon bashkëpunimin me prindërit si një ndër faktorët kryesorë në procesin edukativ të nivelit parashkollor, faktor ky që trajtohet në hipotezën 1: Bashkëpunimi dhe përfshirja më aktive e prindërve në punën edukative në institucionet parashkollore ndikon në rritjen e cilësisë së shërbimeve edukative. Përmirësimi i cilësisë në shkolla, bëhet për të ndikuar në ngritjen e performancës së nxënësve, ndërsa përmirësimi i nivelit të përfshirjes së

---

prindërit, aplikohet edhe për institucionet parashkollore/fëmijët e moshës parashkollore.

prindërve është me rëndësi të veçantë për përmirësimin e cilësisë (Oostdam & Hooge, 2013).

Në anën tjetër, hipoteza ndihmëse trajton ndërlidhjen e faktorëve, si në vijim: Me një ndërlidhje të faktorëve (komunikim, mjedis fizik, njohje me politikat e edukimit parashkollor) arrihet bashkëpunimi konstruktiv ndërmjet institucioneve parashkollore dhe prindërve.

Më pas, në hulumtim trajtohet përmirësimi i bashkëpunimit të institucioneve parashkollore me prindërit, sfidat për përmirësimin e bashkëpunimit dhe ndërlidhja midis faktorëve të bashkëpunimit, ndikimi në qëndrimet dhe në motivimin e prindërve për bashkëpunim, si dhe perceptimi i një bashkëpunimi të tillë nga ana e edukatoreve, në aspektin intelektual. Përkitazi me çështjet e përmendura, janë formuluar pyetjet kërkimore, si në vijim:

Pyetja kërkimore 1: Cilat janë sfidat dhe nevojat për përmirësimin e bashkëpunimit aktual të prindërve me institucionet parashkollore?

Pyetja kërkimore 2: Cila është ndërlidhja ndërmjet faktorëve (komunikimi i mirëfilltë, mjedisi shkollor, qasja e prindërve në politikat e edukimit parashkollor) në zhvillimin e një bashkëpunimi konstruktiv?

Pyetja kërkimore 3: Si mund të përmirësohet bashkëpunimi me prindër në të mirë të punës edukative në institucionet parashkollore?

## ***Prindërit dhe roli pedagogjik i tyre***

Roli pedagogjik i prindërve është definuar nga Epstein (2001) duke iu referuar rritjes së fëmijëve, besimeve dhe pritjeve të prindërve rreth edukimit e dimensionit fizik, i cili nënkupton ambientin e përshtatshëm ku fëmijët do të mund të mësojnë. Prindërit apo kujdestarët kanë ndikim të drejtpërdrejtë në edukimin e fëmijëve dhe, për këtë arsye, duhet të trajtohen nëpërmjet bashkëpunimit, duke vënë në fokus rolin dhe ndikimin e prindit në edukimin e fëmijëve (Epstein J. , 2001).

Më herët, thuhej se prindërit nuk kanë pasur të drejtë të përfshihen në procesin edukativ. Prandaj, një ndryshim i një qasjeje të tillë tradicionale do të ishte i mirëseardhur dhe i dobishëm si për fëmijët, ashtu edhe për shkollën, edukatorët dhe prindërit. Sidomos, nëse nisemi nga premisa se roli i prindërve në procesin arsimor është i dobishëm, qoftë në aspektin e ndihmës individuale, qoftë në pasurimin e përvojave edukative të klasës dhe të shkollës (Miller, 2003, f. 224).

Autori Berger (2004), e thekson funksionin e ngjashëm të familjes, në plotësimin e nevojave të fëmijëve, pavarësisht mundësisë së ndryshimit të strukturës së familjes. Në përgjithësi, janë sugjeruar disa role të prindërve si, p.sh.: roli primar i prindërve, që përkon me përkujdesjen, domethënë të ushqejnë, të mbrojnë, dhe të strehojnë fëmijët. Po ashtu, familjet socializojnë fëmijët në përputhje me normat e shoqërisë dhe me vlerat kulturore. Prindërit kanë përgjegjësi të monitorojnë edukimin e fëmijës në shkollë dhe në familje. Gjithashtu, ata janë edukuesit primarë të fëmijëve të tyre, ndaj aftësia e fëmijëve që të funksionojnë mirë në institucione edukative, varet në masë të madhe nga përkujdesja që kanë marrë në shtëpi (Berger, 2004).

Prandaj, institucionet parashkollore duhet të bashkëpunojnë me prindërit, në mënyrë që të jenë të suksesshme në përmbushjen e misionit të tyre për edukimin e fëmijëve.

Bashkëpunimi me prindërit është po aq i rëndësishëm, sa edhe kurrikula e edukimit parashkollor dhe zhvillimi profesional i edukatorëve. Sipas të dhënave nga gjetjet, në disa institucione vërehet mungesë e interesimit të prindërve për bashkëpunim. Në anën tjetër, shtrohet pyetja: A kanë zhvilluar institucionet ndonjë plan institucional për bashkëpunim me anë të të cilit do të tregonin përkushtimin e vet për një bashkëpunim të tillë? Shpeshherë, nuk synohet të vendoset një qasje e afërsisë në mes të shkollës dhe prindërve. Njëherazi, sipas autorit Plakolli (2011, f. 416 - 417), shpesh ndodh që prindërit të jenë prezent në institucionin parashkollor vetëm në takime të prindërve dhe, po ashtu, mungon përgatitja e duhur e prindërve për t'iu qasur fëmijëve të tyre në mënyrë adekuate.

### *Rëndësia e kulturës së bashkëpunimit*

Sipas autorit Michael Fullan (1999, f. 41), angazhimi i prindërve dhe i komunitetit shihet si veçori kryesore e ndryshimeve organizative. Fullan (1999, f. 43) prezanton karakteristikat e kulturave të bashkëpunimit, nëpërmjet sqarimit teorik, në funksion të arritjes së suksesit në shkollë (organizatë).

Gjithashtu, në librin e Fullan-it "Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim", theksohet rëndësia e kulturës së të punuarit në bashkëpunim (Bryk, Sebring, Kerbow, Rollow, & Easton, 1998). Në fakt, autorët nënkuptojnë ndikimin e shkollës bashkëpunuese në ngritjen e arritjeve të nxënësve. Njëkohësisht, Goldberg, në studimin që i bëri shkollës "Frimën" në Los Anxhelos, e vlerësoi lart momentin kur shkolla në fjalë kaloi nga një shkollë me përparim të dobët, në një shkollë me zhvillim të plotë bashkëpunues, duke përmirësuar njëkohësisht

edhe performancën e nxënësve në mësim (Gallimore & Goldenberg, 2001). Një qasje e tillë reflekton përgjegjësinë për vendosjen e një kulture të bashkëpunimit drejt shkollës si organizatë, duke involvuar këtu të gjeturat e hulumtimit dhe hamendësimin e prindërve për bashkëpunim me IP-të.

Në anën tjetër, autori Gaitan (1999), e ndërlihd rëndësinë e kulturës së bashkëpunimit, duke u bazuar në një studim të bërë në shkolla të Kalifornisë, për përfshirjen aktive të prindërve në shkollimin e fëmijëve të tyre. Në këtë rast, raportohet se pikërisht për faktin që për pjesëmarrje aktive nevojiteshin njohuri specifike kulturore, rrugët konvencionale për bashkëpunimin e prindërve me shkollën ishin të mbyllura, derisa rrugët jokonvencionale, përkundrazi, inkurajonin përfshirjen e prindërve në edukimin e fëmijëve të tyre nëpërmjet komunikimit me përgjegjësi kulturore.

Në anën tjetër, rëndësia e përfshirjes së prindërve korrespondon në arritjet edukative të nxënësve, duke pasur njëherazi një ndikim të fuqishëm (Gonzales et al., 2013). Gjithë kjo, jep një ngjyrim përtej aspektit të bashkëpunimit me prindërit, duke e pasqyruar rëndësinë e kulturës së bashkëpunimit, nga aspekti i përgjithshëm, si faktor i ndërveprimit të të gjithë subjekteve, në funksion të suksesit të nxënësve dhe me këtë, në funksion edhe të institucionit parashkollor. Si do të arrihej sukcesi i IP-së? Natyrisht, nga rezultatet e fëmijëve, që vijnë si pasojë e bashkëpunimit konstruktiv. Derisa, pikërisht kjo, e vë në dukje rëndësinë e kulturës së bashkëpunimit ndërmjet prindërve dhe mësuesve<sup>4</sup>, duke theksuar ndikimin e këtij bashkëpunimi në zhvillimin dhe në edukimin e fëmijës (Sewell, 2012).

Derisa theksohet fuqishëm se kultura e bashkëpunimit mund të kontribuojë në rritjen e motivimit për të mësuar dhe në

---

<sup>4</sup> Nëse literatura flet për mësuesit, shpjegimi i njëjtë vlen edhe për edukatorët.

krijimin e bindjes për dobinë nga edukimi, bashkëpunimi efektiv dhe komunikimi i hapur mund të sigurojë shkollën lidhur me parashikimet për origjinën kulturore si dhe t'i tregojë kufizimet dhe dallimet (Gonzales et al., 2013). Në çdo alternativë, kultura e bashkëpunimit na shfaqet me një ndikim pozitiv, qoftë edhe në aspektin e motivimit për të mësuar, por që lë për të besuar edhe për involvimin e motivimit të prindërve për bashkëpunim! Kjo del në pah, kur autori Fullan (2001) e ndërlidh përmirësimin e të nxënit, drejt një qasjeje pozitive, pikërisht me shkollën bashkëpunuese!

*Përvioja ndërkombëtare përkitazi me kulturën e bashkëpunimit të prindërve me institucionet parashkollore*

Nëse kthejmë vështrimin në qasjen institucionale për rëndësinë e bashkëpunimit me prindërit, ne do të shohim eksperiencën të ndryshme, si p.sh.: institucionet relevante në Suedi, që përfshijnë fëmijët e moshës 1- 5 vjeç.

Në praktikën suedeze, prindërit janë pjesë e institucionit, meqë janë në kontakt të rregullt me institucionin parashkollor. Përveç kësaj, kurrikula e edukimit parashkollor parasheh rëndësinë e komunikimit dhe të bisedës, si një mjet të ndërtimit të raportit ndërmjet shkollës dhe familjes. Ky ndërveprim ndërmjet familjes dhe shkollës ka në fokus zhvillimin, të mësuarit dhe mirëqenien e fëmijës, si në shtëpi ashtu edhe në IP. Njëherazi, praktika suedeze tregon për organizimin e konferencave me prindërit, si të rëndësishme për të mbajtur dhe për të zhvilluar raportet ndërmjet familjes dhe institucionit parashkollor. Gjatë këtyre takimeve, zakonisht diskutohet me prindërit për fëmijën ku edukatori/ja arrin të mbajë aktiv prindin dhe ta motivojë nëpërmjet përdorimit të një objekti, të ashtuquajtur "kartoni i fortë". Edukatorët aplikojnë kartonët, në mënyrë që të vetëdijësojnë prindërit për të qenë "prindër



parashkollorë mjaft të mirë“, të cilët janë bashkëpunues dhe të gatshëm për të kategorizuar dhe për të etiketuar fëmijët e tyre (Markstrom 2011).

### ***Motivimi i prindërve për bashkëpunim me institucione parashkollore***

Prindërit dhe familja në tërësi janë një urë lidhëse ndërmjet të të nxënit të fëmijës në institucione parashkollore dhe të nxënit në shtëpi, ndërsa “E drejta për iniciativa, organizim dhe planifikim të bashkëpunimit edukator - prind i takon kryesisht, institucionit” (Deva-Zuna, 2009).

Në shumë raste, si prindërit, ashtu dhe edukatorët e fajësonin njëri -tjetrin për problemet dhe për vështirësitë në institucionet parashkollore, përderisa zgjidhja mund të gjendej vetëm nga puna në ekip!

Në mënyrë që të motivohen prindërit për një bashkëpunim me IP-në, duhet të kenë ndikim institucioni dhe edukatorët.

Në takimet e prindërve, mësimdhënësi duhet të influencojë prindërit, që të ndihen rehat për shkak të fëmijës së tyre dhe të aftësive prindërore. Atëherë, prindërit dhe mësimdhënësit si ekspertë, në bashkëpunim, mund të gjejnë një zgjidhje të lehtë për fëmijën (Miller, 2003, f. 225). Me një fjalë, motivimi i prindërve për bashkëpunim varet nga aftësia e një mësuesi për të angazhuar atë (prindin) në mbështetje të të nxënit të fëmijës. Këtë e arrin nëpërmjet komunikimit me secilin prind në mënyrë pozitive, si dhe duke e vlerësuar kontributin e tyre në mbështetje të fëmijës në institucione shkollore (Epstein J. , 2013).

Nëse e ndërlihim çështjen e motivimit me pyetjen kërkimore 1, dilema bie pikërisht në motivimin si një sfidë dhe, njëkohësisht, si një nismë e mirë për të punuar më shumë drejt

motivimit të prindërve, duke ndikuar në përmirësimin e bashkëpunimit aktual. Ndërkohë, edhe dokumenti i standardeve jep shembullin më të mirë të ndërlidhjes me motivimin e prindërve për përfshirje në institucione parashkollore. Këtë e arrin pikërisht kur përshkruan kushtet që duhet t'i ofrojë për të zhvilluar bashkëpunimin me prindër, duke motivuar përfshirjen më aktive të prindërve (shih pikën 2.2). Shtrohet pyetja: Çfarë thonë rezultatet e hulumtimit?

#### *Qasja e institucioneve parashkollore drejt bashkëpunimit me prindër*

Autori Graham (2011) potencon se *përfshirja e prindërve dhe pjesëmarrja e prindërve* në edukimin e fëmijëve të tyre përbën nocionin e bashkëpunimit shkollë-familje. Prandaj, *përfshirja e prindërve* është një term i aplikuar si term esencial i pjesëmarrjes së shtëpisë, shkollës dhe komunitetit në aktivitete që mbështesin zhvillimin e fëmijës, ndërsa *pjesëmarrja e prindërve* i takon kontekstit të përfshirjes së prindërve, duke përforcuar përfshirjen e prindërve në rolin e vendimmarrësit të programeve edukative, menaxheriale dhe administrative.

Sipas kësaj, formacioni australian për familje - shkollë - komunitet ka paraqitur një definicion:

Marrëdhëniet bashkëpunuese dhe aktivitetet përfshijnë stafin e shkollës, prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes së nxënësve në një shkollë. Partneritetet efektive bazohen në besimin dhe respektin reciprok dhe në përgjegjësinë e përbashkët për edukimin e fëmijëve dhe të rinjve në shkollë (Department of Education, 2008)''

Autori Michael Fullan (1999, f. 37) konsideron vetëm shkollën bashkëpunuese, si të tillë, vendimtare drejt suksesit. Gjithashtu, sipas autorit Sewell (2102), qasja komunikative dhe

mirëkuptuese ndërmjet dy komuniteteve mundëson plotësimin e nevojave të fëmijëve. Derisa, shumë me rëndësi konsiderohet edukimi i mësimdhënësve, në mënyrë që të kuptojnë nevojën për një integrim dhe bashkëpunim të tillë. Ky aspekt do të plotësohet edhe përmes respektimit të standardeve të edukimit dhe arsimit parashkollor, gjë që rrit vetëdijësimin e edukatoreve për rolin e tyre në ndërtimin e kapaciteteve dhe kushteve për një bashkëpunim konstruktiv.

#### *Këndvështrimi i standardeve të edukimit parashkollor*

MASHT-i ka një politikë mjaft të avancuar ku përcaktohen standardet e shërbimeve të edukimit parashkollor. Standardet kanë qëllim njoftues për përgjegjësit e institucioneve dhe edukatorët, lidhur me punën e tyre. Prej gjithsej shtatë fushave të standardeve, ky dokument ia kushton një standard të veçantë (numër 4) bashkëpunimit me familjen. Në mesin e aktiviteteve të tjera, brenda institucioneve parashkollore, standardet e edukimit parashkollor parashikojnë edhe përfshirjen e prindërve. Në të njëjtën kohë, institucionet parashkollore: a) sigurojnë informacion për prindërit; b) bëjnë mbledhjen e informacionit në dobi të fëmijës dhe familjes; c) mbështesin prindërit; d) krijojnë kushte për përfshirjen e prindërve; e) sigurojnë komunikimin prind – personel përmes mjeteve të ndryshme; f) informojnë prindërit formalisht; g) përfshijnë prindërit brenda kështillit këshillues aktiv (MASHT, 2006, f. 33).

Prindërit janë përdorues të standardeve (MASHT, 2006, f. 10) dhe, pikërisht, duke u nisur nga ky aspekt krijohet koherencë ndërmjet standardeve dhe njërës ndër faktorët (njohja me politikën e edukimit parashkollor) që trajton pyetja kërkimore 2 dhe hipoteza ndihmëse (shih më lart).

Derisa arsyeja që prindërit shfrytëzojnë standardet, lidhet me informimin e nevojshëm për zhvillimet brenda IP-së, me të

kuptuarit e standardeve të veprimtarisë edukative, me njohjen dhe me vlerësimin e nivelit të realizimit të standardeve në IP, si për arsye të përfshirjes në veprimtaritë edukative në institucionin parashkollor (MASHT, 2006, f. 11).

Bazuar në standardet e edukimit parashkollor ka rrjedhur ideja e hulumtimit, pikërisht duke pasur si pikësynim ndikimin e përfshirjes aktive të prindërve në rritjen e cilësisë në institucione parashkollore dhe në krijimin e kushteve për bashkëpunim, nga institucionet parashkollore.

### *Metodologjia e hulumtimit*

Për realizimin e hulumtimit është aplikuar qasja e metodës cilësore, nëpërmjet intervistës me edukatorët, si dhe qasja sasiore, nëpërmjet teknikës së anketimit me prindërit.

Njëkohësisht, në fokus të hulumtimit kanë qenë fëmijët e grupmoshave 3-6 vjeçare, duke hulumtuar këndvështrimin e prindërve të fëmijëve të kësaj moshe, si më lart, dhe duke intervistuar edukatorët që punojnë me këtë moshë të fëmijëve. Për të realizuar hulumtimin, subjekt të hulumtimit ishin edukatorët dhe prindërit e fëmijëve të moshës parashkollore. Studimi është realizuar në Prishtinë, në Ferizaj dhe në Gjakovë.

Përzgjedhja e mostrës është bërë nëpërmjet të bazuarit në qasjen e llojit joprobabilitar, të qëllimshëm, duke eksploruar dhe interpretuar përvojat dhe perceptimet e pjesëmarrësve në hulumtim, të cilët janë përzgjedhur duke u bazuar në përvojën dhe karakteristikat, përkitazi me fushën e studimit (Matthews & Ross, 2010, f. 167). Në këtë rast, numri i prindërve pjesëmarrës në hulumtim është 60 prindër në tri qendra, që nënkupton nga 20 prindër në secilën qendër, në Prishtinë, në Gjakovë dhe në Ferizaj. Derisa janë intervistuar 12 edukatore, nga 4 në secilën qendër (si më lart). Përzgjedhja është bërë si në

vijim: 2 edukatore në një institucion publik dhe dy edukatore në një institucion privat, në secilën qendër.

Instrumentet e hulumtimit, kanë shërbyer për të realizuar hulumtimin. Në studimin tonë instrumente të hulumtimit janë: pyetësori i zhvilluar me prindër, si dhe protokoll i intervistës, që ka shërbyer si instrument për të realizuar intervistat me edukatore. Pyetësori është ndërtuar, kryesisht, duke u bazuar në dokumentin “Standardet e përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor në Kosovë (3-6 vjeç)” dhe çështjet kryesore që trajton fusha e katërt e standardeve.

Për analizën e të dhënave nga intervistat janë aplikuar disa qasje analitike, në mënyrë që rezultatet të jenë sa më të qarta. Fillimisht përmes *qasjes së bazuar* janë përpunuar të dhënat nga intervistat, të cilat në fillim, si të papërpunuara, janë marrë në formë të shkruar. Në vazhdim, *qasja e interpretimeve të kuptueshme* ka ndihmuar padyshim, për të transmetuar të dhënat në mënyrë sa më të qartë, ndërsa definimi i qartë i të dhënave nga intervistat është dhënë nëpërmjet *qasjes tematike*. Pyetjet janë paraqitur në një tabelë, nëpër kolona dhe janë dhënë përgjigjet përkatëse të secilit intervistues. Në këtë mënyrë, për të lehtësuar nxjerrjen e të dhënave dhe të çështjeve kyçe për elaborim, është përcaktuar *treguesi (indeksimi)*. Të dhënat nga të intervistuarit janë koduar, sipas përgjigjeve të secilit intervistues. Fillimisht, të dhënat nga përgjigjet e ndërlidhura me çështjet kyç janë paraqitur në një tabelë, për t’u analizuar më pas nëpërmjet skemave, sipas aspekteve relevante të hulumtimit (Matthews & Ross, 2010, f. 372-385).

Të dhënat sasiore janë analizuar nëpërmjet Paketës Statistike për Analizën e të dhënave në Shkencat Sociale (SPSS), duke aplikuar analizën përshkruese – frekuencat. Në vazhdim, për të trajtuar konsistencën e brendshme (matjen e sigurisë së pyetësorit), është bërë analiza Cronbach Alpha, për të konfirmuar se të dhënat janë rezultat i gjetjeve dhe jo i

mosfunksionimit të pyetësorit. Gjithashtu, është aplikuar analiza e korrelacionit për të matur lidhshmërinë ndërmjet dy variablave (në këtë rast të faktorëve sipas pyetjeve dhe hipotezave kërkimore).

### *Analiza e të dhënave të hulumtimit*


#### *Analiza e të dhënave cilësore*

Të dhënat nga intervistat janë vendosur në tabelë, sipas klasifikimit të përgjigjeve (tabela në aneks), në të cilën vërejmë kategorizimin e përgjigjeve sipas rëndësisë, të ndërlidhur me çështjen në fokus të hulumtimit, duke u paraqitur aspekti i përgjithshëm i përgjigjes dhe duke u elaboruar më në detaje, si tema kyçe, përmes skemave.

Në këtë kontekst, analiza e të dhënave të metodës cilësore – të grumbulluara përmes intervistave, është përmbledhur në katër dimensione specifike, si në vijim:

- Niveli dhe mënyrat e bashkëpunimit të IP-së me familjen;
- Politikat e edukimit parashkollor dhe prindërit;
- Mjedisi fizik dhe pajisja me material didaktik dhe teknologjik;
- Sfidat e bashkëpunimit të IP-së me familjen.

*Bashkëpunimi i institucioneve parashkollore me prindërit drejt edukimit në fëmijërinë e hershme*



*Ilustrimi 1. Gjendja e bashkëpunimit me familjen*

*Prezantimi dhe analiza e rezultateve*

Duke u nisur nga **dimensioni i parë kyç** – *Niveli dhe mënyrat e bashkëpunimit* (shih katër çështjet specifike), në ilustrimin (nr 1.) më lart, pyetjet 1, 2, 3 dhe 6 të protokollit të intervistës trajtojnë aspektin e komunikimit të IP-së me familjen (prindërit), ku dhe vërehet një nivel i mirë i bashkëpunimit, nëpërmjet formave të ndryshme të bashkëpunimit, që është edhe në koherencë me standardet e edukimit parashkollor (shih pikat C, D, E, F të standardit nr. 4). I intervistuari me kodin IKPR1 e mbështetet këtë nëpërmjet përgjigjes si në vijim: “Bashkëpunimi me prindër është në nivel dhe zhvillohet nëpërmjet mbledhjeve të organizuara, ftesave për organizimin e aktiviteteve përkitazi me profesionin”. Shpesh, arsyeja e një bashkëpunimi me prindër, është pikërisht përfshirja e përvijës profesionale të prindërve në IP, që në fakt është njëra ndër format më efektive të bashkëpunimit (pika D/5 në standardin 4). Kjo shpie drejt

identifikimit të shkathtësive të fëmijëve, kur bëhet fjalë për përzgjedhjen e profesionit, qysh në moshë të hershme, si dhe drejt të njohurit të profesioneve të ndryshme dhe ndikimit të secilit profesion.

Në anën tjetër, nga gjetjet e analizës cilësore gjatë trajtimit të çështjes së parë kyç, vërehet mungesë e kreativitetit dhe e seriozitetit për një bashkëpunim të mirëfilltë me prindërit apo edhe mungesë të një forme të organizimit të bashkëpunimit përmes aktiviteteve.

Nëse ndalemi te **dimensioni i dytë kyç**, që ka të bëjë me njohjen e prindërve me politikat e edukimit parashkollor, këtë e trajton pyetja nr. 4 e protokollit të intervistës, si dhe pika D/1 e standardit katër të edukimit parashkollor, që në fakt është në shpërputhje me rezultatet e hulumtimit. Këtë aspekt do të mund ta shpjegojmë si një çështje, që na paraqitet si mjaft e njohur për prindërit, por që në fakt nuk shpjegohej përmes një arsytimi bindës. Njëherazi, sipas të intervistuarve, prindërit janë pjesë e vendimmarrjes në IP (që e mbështet edhe pika G/2 e standardeve), por nuk jepen fakte nëse kanë prindërit qasje në politikat e edukimit parashkollor (standardet dhe kurrikula e edukimit parashkollor) apo nëse janë pjesë e hartimit të politikave apo edhe pjesë përbërëse. Kjo do të mund të vendosej nëpërmjet trajnimit për funksionalizimin e politikave, në mënyrë që prindërit të njohin thelbin e ndikimit të politikave në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve.

Rreth **çështjes së tretë - mjedisit fizik** në institucionet parashkollore, të përfshirë në pyetjen nr. 5, gjithashtu vërehet një lloj neglizhence e edukatoreve lidhur me këtë çështje. Edukatorët pohojnë pajisjen e institucioneve me material didaktik dhe atë teknologjik, duke i shfrytëzuar ato në mënyrë racionale, derisa nuk vërehet një përshtatje e mjedisit fizik drejt inkorporimit të aktiviteteve në funksion të bashkëpunimit me prindërit. Shembullin për një pohim të tillë e jep i intervistuari



me kodin IKFR4: “Kopshti i plotëson të gjitha kushtet; është i pajisur me materiale të ndryshme didaktike që nevojiten për fëmijët e moshës parashkollore”. Gjithashtu, nuk vërehet një mobilizim i të dy palëve drejt identifikimit të pasojave nga përdorimi i tepërt i teknologjisë informative, në rast nevoje.

Njëkohësisht, çështja e mjedisit fizik, që si variabël trajtohet në pyetjen kërkimore 2 dhe në hipotezën ndihmëse, rrjedh nga fusha nr. 3 e standardeve të edukimit parashkollor, duke e trajtuar mjedisin si ambient nxitës të lojës dhe të të nxënit (pika a,b,c), si dhe pajisjen me material didaktik (pika d).

Ndërsa **dimensioni i paraqitjes së sfidave në rrugën e bashkëpunimit** ndërmjet dy faktorëve me rëndësi, për edukimin dhe mirëqenien e fëmijëve, ndërlidhet me mosinteresimin e prindërve për bashkëpunim, përkitazi me bartjen e përvojave profesionale. Në këtë kontekst, mund të flitet për një mungesë të mekanizmave vetëdijësues dhe të aplikimit të strategjive motivuese për prindërit. Andaj, këtu del në pah mosinformimi i mjaftueshëm i prindërve për politikën e edukimit parashkollor dhe dobitë e dokumenteve relevante lidhur me edukimin dhe mirëqenien e fëmijëve. Njëherazi, si sfiduese shihet edhe mosinteresimi (egoizmi) i prindërve të fëmijëve me nevoja të veçanta për bashkëpunim me IP-në dhe edukatorët. Në këtë rast, vendoset një mur ndarës, drejt një: a) trajtimi të mirëfilltë të këtyre fëmijëve; b) drejt një përkushtimi serioz; si dhe c) drejt identifikimit të nevojave të tyre. Gjithashtu, specifikohet çështja e mosrespektimit të rregullave të IP-së nga prindërit, përkundër marrjes me kohë të informatave për rregullat e IP-së, gjë që tregon një joseriozitet të prindërve dhe mungesë të theksuar të nevojës për bashkëpunim.

Nëse analizojmë dallimet ndërmjet institucioneve publike dhe atyre private, mund të konkludojmë se në institucionet private edukatorët kanë një qasje më serioze, si në

bashkëpunimin me prindërit, ashtu dhe në trajtimin e çështjes së bashkëpunimit gjatë procesit të intervistimit. Ndërsa nga edukatorët e institucioneve publike shihet një neglizhencë pak më e madhe. Kjo gjendje mund të rrjedhë si pasojë e dokumentit të standardeve në dispozicion, i cili nga institucionet konsiderohet si dokument detyrues për zbatim. Një gjendje e tillë nxit dilemat për mangësi gjatë hartimit të politikave, mungesë të shkathtësive, të kompetencave ose të kualifikimit relevant të lidershit në institucionet publike, për të aplikuar dhe për të kuptuar drejt standardet në institucionet publike.

Njëherazi, nga dy institucione private, rrjedh se niveli i bashkëpunimit me prindërit, është deri diku i mirë, gjë që vë në dyshim një bashkëpunim të mjaftueshëm, për të ndikuar në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve. Gjithashtu, në njërin nga institucionet private është vërejtur një qasje më kreative. Aty aplikohet në mur një pasqyrë informuese për prindërit lidhur me aktivitetet që aplikohen me fëmijë.

#### *Analiza e të dhënave sasiore*

Në analizën sasiore, pyetjet janë strukturuar sipas faktorëve të ndryshëm, duke u bërë analizat për validitet të faktorëve, të përshkruara në vazhdim. Pyetjet që kanë matur të njëjtën variabël (faktor) janë integruar në një faktor të vetëm dhe janë analizuar.

Siç shihet nga tabela (nr.1) më poshtë, në studim janë përfshirë pjesëmarrës (të anketuar) nga tri qytete të Kosovës, më saktësisht, nga Prishtina (N=20), nga Ferizaj (N=20) dhe nga Gjakova (N=20). Për sa i përket moshës së fëmijës, 16 pjesëmarrës kanë cekur se fëmija i tyre është në mes 1-3 vjeç, 9 të tjerë kanë theksuar se fëmija i tyre i takon grupmoshës 3-4 vjeçare. Po ashtu, 11 pjesëmarrës kanë deklaruar se fëmija i tyre

*Bashkëpunimi i institucioneve parashkollore me prindërit drejt edukimit në fëmijërinë e hershme*

është në mes të moshës 4 dhe 5 vjeç, ndërsa rreth 40% të pjesëmarrësve kanë pasur një fëmijë të moshës 5-6 vjeçare. Pjesëmarrës në studim, kanë qenë kryesisht nënat (N=55, 91.7%), dhe vetëm një pjesë e vogël ishin baballarë (N=5, 8.3%). Njëkohësisht, të njëjtit (pjesëmarrësit), janë pyetur nëse kanë ndonjë profesion, derisa përgjigjet e tyre dëshmojnë se pjesa dërrmuese nuk kanë ndonjë profesion (N=54) dhe vetëm 6 prej tyre kanë deklaruar se në fakt kanë një profesion.

Tabela 1. Të dhënat demografike: vendbanimi, moshja e fëmijës, gjinia e prindit dhe profesioni

= 60	Vendbanimi		Moshja		Gjinia e prindit		Profesioni i prindit	
	(N)	(%)	(N)	(%)	(N)	(%)	(N)	(%)
Prishtinë	20	33.3%						
Ferizaj	20	33.3%						
Gjakovë	20	33.3%						
1-3			16	26.7%				
3-4			9	15%				
4-5			11	18.3%				
5-6			24	40%				
Femra					55	91.7%		
Meshkuj					5	8.3%		
Me profesion							54	90%
Pa profesion							6	10%

Pyetjet e parashtruara për matjen e komunikimit ndërmjet prindërve dhe edukatoreve kanë treguar një shkallë me konsistencë të mirë, siç është përcaktuar edhe përmes vlerës së Cronbach alpha prej 0.76, shih në tabelën nr. 2. Në anën tjetër, pyetjet që kanë pasur për synim matjen e bashkëpunimit midis prindërve dhe edukatoreve kanë treguar një shkallë me konsistencë të varfër, siç është përcaktuar edhe nga vlera e Cronbach alpha prej 0.51. Pyetjet që kanë matur mjedisin fizik në IP, kanë treguar një shkallë me konsistencë të

papranueshme, siç është përcaktuar edhe nga vlera e Cronbach alpha prej 0.44.

Ndërsa pyetjet e parashtruara për matjen e njohurive të prindërve mbi politikat e edukimit parashkollor kanë treguar një shkallë me konsistencë të mirë, siç është pasqyruar edhe nga vlerat e Cronbach alpha prej 0.72.

Tabela 2. Statistikat përshkruese dhe Cronbach Alpha  
Shënim. N=60.

Variabla	Cronbach's Alpha	Mesatarja	Devijimi standard	Rangu
Komunikimi prind – edukatore	.76	1.50	.47	1-5
Bashkëpunimi prind – edukatore	.51	1.56	.45	1-5
Mjedisi fizik	.44	2.05	.53	1-5
Njohuritë e prindërve me politikat e ed.parashkollor	.72	2.14	.68	1-5

Prandaj, konstatohet se ndërlidhja më e mirë drejt bashkëpunimit konstruktiv (si variabël e varur) qëndron pikërisht te faktorët, siç janë komunikimi dhe mundësia e të njohurit të prindërve me politikat e edukimit parashkollor (kurrikula, standardet).

Tabela 3. Korrelacioni ndërmjet variablave

	1	2	3	4
1. Komunikimi	-			
2. Bashkëpunimi	.543**	-		
3. Mjedisi fizik	.139	-.134	-	
4. Njohuritë e prindit me politikat e edukimit parashkoll.	.487**	.249	.241	-

Sipas analizës së korrelacionit, ndërmjet variablave (tab.3) është gjetur korrelacion pozitiv ndërmjet bashkëpunimit e komunikimit të prindërve dhe IP-së,  $r(60)=.543$ ,  $p<0.001$ . Po

ashtu , sipas analizës së korrelacionit ndërmjet variablave, është gjetur korrelacion pozitiv ndërmjet njohurisë së prindërve me politikat e edukimit parashkollor (mundësisë së prindërve për të njohur kurrikulën e edukimit parashkollor) dhe komunikimit ndërmjet prindërve dhe IP-së,  $r(60)=.487$ ,  $p<0.001$ .

### *Përfundime dhe rekomandime*

Nisur nga gjetjet e hulumtimit është arritur të identifikohen disa konkluzione të ndara në specifika të trajtuara, sipas qëllimit të studimit.

*Në aspektin teorik* është trajtuar roli pedagogjik i prindërve dhe në këtë kontekst rëndësia e krijimit të një kulture të bashkëpunimit, si dhe motivimi i prindërve për bashkëpunim me IP-në. Kjo vendos një koherencë me rezultatet e hulumtimit, pikërisht në aspektin e të kuptuarit të rëndësisë së bashkëpunimit, nëpërmjet të njohurit të rolit pedagogjik të prindërve. Gjithashtu, ndërlidh aspektin e të kuptuarit të rëndësisë së motivimit të prindërve, për të krijuar një shtyllë të qëndrueshme të bashkëpunimit konstruktiv.

Nëse bazohemi në *standardet e edukimit parashkollor* dhe në fushën e bashkëpunimit me prindërit, identifikojmë se standardet trajtojnë dhe mbështesin fushën e bashkëpunimit me prindër, duke shfaqur rëndësinë e një bashkëpunimi të tillë, për rritjen e cilësisë së shërbimeve edukative (shih Hipotezën 1). Njëkohësisht, standardet parashohin një ndërlidhje të faktorëve (sipas hipotezës ndihmëse dhe pyetjes kërkimore 2), që do të ndihmonte bashkëpunimin konstruktiv. Prandaj, ofrimi i mundësisë së prindërve për qasje dhe njohje me politikat e edukimit parashkollor, shpie drejt një vetëdijësimi për bashkëpunim konstruktiv.

Në anën tjetër, pas analizës së të dhënave nga intervistat me edukatore dhe nga anketimi me prindërit, mund të dalim me disa konkludime, duke ndërlidhur pyetjet kërkimore dhe hipotezat e parashtruara. Përfundimet e arritura, në përpjekje për t'iu përgjigjur pyetjes së parë kërkimore, janë identifikuar nëpërmjet gjetjeve nga intervistat.

*Përfundime nga analiza cilësore:* Nga të dhënat në dispozicion, të dala nga intervistat, do të mund të identifikojmë sfidat e bashkëpunimit, në IP, si: mosinteresi i prindërve për bashkëpunim dhe jogatishmëria e prindërve të fëmijëve me nevoja të veçanta për të pranuar fëmijët e tyre si të tillë. Në anën tjetër, theksohet *një mungesë e mekanizmave relevante drejt motivimit të prindërve për të njohur politikat e edukimit parashkollor (standardet dhe kurrikulën)*. Motivimi do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në vetëdijësimin e prindërve për rëndësinë e respektimit dhe aplikimit të tyre. Ai, duke qenë pjesëmarrës aktiv në funksionalizimin e këtyre politikave, do të përbente elementin kyç për rritjen e cilësisë së shërbimeve edukative, për edukimin dhe mirëqenien e fëmijëve. Njëkohësisht, vërehet *mungesë e një mjedisi fizik të përshtatshëm për ofrimin e mundësive për bashkëpunim, ndërsa krijimi i një mjedisi, që plotëson kushtet e punës me fëmijë, do të kishte ndikim edhe në identifikimin e mangësive apo të përparësive të përdorimit të mjeteve teknologjike, që do të arrihej nëpërmjet bashkëpunimit me prindërit.*

Përkitazi me gjendjen sipas të dhënave nga hulumtimi, gjithashtu shtrohet domosdoshmëria për një ndërveprim dhe pjesëmarrje më aktive të prindërve për bartjen e përvojave profesionale brenda institucioneve, duke ofruar mundësi për fëmijët që të njihen me profesione të reja. Një domosdoshmëri e tillë do të kishte ndikim në informimin fillestar të fëmijëve të moshës së hershme për orientim profesional.

Më tutje, vërehet një bashkëpunim i prindërve me IP-në, nëpërmjet formave të ndryshme, si: takimeve ditore dhe takimeve të përgjithshme dy herë në vit, bartjes së informatave nëpërmjet përfaqësuesit të prindërve, por me një dozë të mungesës së kreativitetit dhe seriozitetit në aspektin e organizimit të formave të bashkëpunimit nëpërmjet aktiviteteve. Ndërsa nga hulumtimi reflektohet qasje më serioze nëpër institucione parashkollore private, sa i përket trajtimit të çështjes, gjë që mund të jetë ndikuar nga standardet e edukimit parashkollor, të cilat konsiderohen nga institucionet parashkollore si dokument që duhet t'i përmbahen dhe duhet zbatuar.

*Përfundime nga analiza sasiore:* Sa i përket ndërlidhjes së faktorëve, drejt zhvillimit të bashkëpunimit konstruktiv të prindërve me IP, më së miri shfaqet në korrelacioni faktori i komunikimit dhe i njohjes së prindërve me politikat e edukimit parashkollor.

Në përpjekje për të interpretuar përfundimet, përkitazi me verifikimin e hipotezave, kemi arritur rezultatet, ku hipoteza e parë vërtetohet duke u bazuar te gjetjet e arritura nga intervistat, si dhe hipoteza ndihmëse, arrin të vërtetohet, pikërisht nga ndërlidhja e dy faktorëve, si më lart.

Nga këndvështrimi i përgjithshëm, duke u bazuar në standardet e edukimit parashkollor, të aspektit teorik dhe atij empirik konkludohet se, nëpërmjet vetëdijësimit të prindërve dhe të institucioneve parashkollore për rëndësinë e bashkëpunimit, arrihet në tejkalimin e sfidave të shumta dhe daljes në pah të formave të ndryshme të bashkëpunimit. Nëpërmjet respektimit dhe zbatimit të standardeve të edukimit dhe arsimit parashkollor do të arrihen të vendosen shtyllat e një bashkëpunimi konstruktiv.

*Rekomandime:* Rezultatet e hulumtimit, si dhe situata aktuale, duke iu përgjigjur edhe pyetjes kërkimore 3, sjellin disa rekomandime:

- Për t'u krijuar një bashkëpunim konstruktiv dhe përmirësim i cilësisë së shërbimeve edukative në institucione parashkollore, shtrohet domosdoshmëria e aplikimit të standardeve të edukimit parashkollor, duke nisur nga institucioni parashkollor si dhe nga edukatorët dhe prindërit;
- Për t'u përmirësuar bashkëpunimi i IP-së me prindërit, nevojitet vetëdijësim i institucionit dhe i edukatoreve për respektimin e standardeve, drejt implementimit të tyre me përpikëri. Gjithashtu, nevojitet vetëdijësim i prindërve për rolin e tyre në përmirësimin e punës edukative;
- Për të tejkaluar sfidat, nevojitet mobilizim i institucionit, edukatoreve dhe prindërve;
- Për të motivuar prindërit, duhet që:
  - a) institucioni të përkujdeset për krijimin e një mjedisi fizik të përshtatshëm për bashkëpunim;
  - b) edukatorët të shprehin aftësitë për bashkëpunim, nëpërmjet kreativitetit, krijimit të kushteve dhe klimës pozitive që ata të ndihen mirë brenda institucionit;
  - c) edukatorët të tregojnë aftësi për të angazhuar prindërit në mbështetje të fëmijëve të tyre.
- Për të ngritur nivelin e kulturës së bashkëpunimit, në mënyrë që fëmijët të ndihen mirë dhe të motivohen për t'u përfshirë në procesin edukativ, nevojitet mobilizim i trekëndëshit "IP, prind, edukatore" duke kuptuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe të kontributit profesional të prindërve.



## **Referencat**

Barnard, W. (2004). Parent involvement in elementary school and educational attainment. *Elsevier*, 39-62.

Berger, E. (2004). *Parents as partners in education*.

Bryk, Sebring, Kerbow, Rollow, & Easton. (1998). Charting Chicago school reform. In Fullan, *Kuptimi i ri i ndryshimit ne arsim*. Westview Press.

Coleman, J. (1988). Social Capital in the Creation of Human Capital. *The American Journal of Sociology*, 94, 95-120.

Department of Education, E. a. (2008). *Family - School Partnership Framework*.

Deva-Zuna, A. (2009). *Partneriteti shkollë - familje - komunitet (sfidë vijanoze)*. Prishtinë.

Epstein, J. (2001). *School, Family, and Community Partnerships*.

Epstein, J. (2013). Ready or not? Preparing teacher educators for school, family and community partnerships. *Teaching Education*, 24/2, 115-118.

Fullan, M. (1999). *Change Forces: The Sequel*. Philadelphia: Routledge Falmer.

Fullan, M. (2001). *Kuptimi i ri i ndryshimit ne arsim*. Tirana: Edualba.

Gaitan, C. (1991). Involving Parents in the Schools: A Process of Empowerment. *American Journal of Education*, 20-46.

Gallimore, R., & Goldenberg, C. (2001). Analyzing cultural models and settings to correct minority achievements and school improvement research. In Fullan, *Kuptimi i ri i ndryshimit ne arsim*. Education Psychologist.

Gonzales, L. M., Borders, L. D., Hines, E. M., Villalba, J. A., & Henderson, A. (2013). Parental Involvement in Children's Education. *Professional School Counseling*, 16(3), 185-193.

Graham, D. (2011). Family-school partnerships: towards sustainable pedagogical practice. *Asia-Pacific Journal of Teacher Education*, 39, 165-176.

Markstrom, A. M. (2011). To Involve Parents in the Assessment of the Child in Parent-Teacher Conferences: A Case Study. *Early Childhood Educ J*, 465-474.

MASHT. (2006). *Standardet e përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor në Kosovë (3-6 vjeç)*.

Matthews, B., & Ross, L. (2010). *Metodat e hulumtimit, udhëzues praktik përshkenat sociale dhe humane*. Tiranë: CDE.

Miller, B. (2003). *Si të krijohet kontakti i suksesshëm me nxënësit*. Prishtinë: QPEA.

Morrison, G. (2007). *Early Childhood Education Today*. Ohio: Kevin M. Davis.

Office of Student services, O. o. (2002). *Collaborative Family - School Relationship for children's Learning*. Richmond: Virginia Department of Education.

Oostdam, R., & Hooge, E. (2013). Making the difference with active parenting; forming educational partnerships between parents and schools. *European Journal of Psychology of Education*, 29(2), 337 - 351.

Plakolli, Z. (2011). Rëndësia e funksionimit të komunikimit shkollë - prind. *Kerkime pedagogjike*, pp. 414 - 429.

Sandberg, A., & Vuorinen, T. (2008, June). Preschool-home cooperation in change. *International Journal of Early Years Education*, 151-161.

*Bashkëpunimi i institucioneve parashkollore me prindërit drejt edukimit në fëmijërinë e hershme*

Sewell, T. (2012). Are we Adequately Preparing Teachers to Partner with Families. *Early Childhood Education Journal*, 259-263.

Skouteris, H., Brittany, W., & Jerrad, L. (2012, December). Preschool children's transition to formal schooling: The importance of collaboration between teachers, parents. *Australasian Journal of Early Childhood*, 37, 78-85.

Taguchi, H. L., & Munkammar, I. (2003). *Consolidating Governmental Early Childhood Education and Care Services under the Ministry of Education and Science: A Swedish Case Study. Early Childhood and Family Policy Series*. UNESCO.

